

Eduard SHEHI

---

*TESSERAE DHE TABULAE LUSSORIE TË ZBULUARA NË  
DYRRACHIUM*

Tematikat studimore mbi lojërat në antikitet përbëjnë ndër aspektet më pak të prekura në arkeologjinë shqiptare. Në ato pak raste ku ceken të tilla çështje bëhet fjalë ose për paraqitjen e strukturave arkitektonike të destinuara për organizime lojërash, si amfiteatër<sup>1</sup> apo stadiume<sup>2</sup> ose për aspektet epigrafike të tyre<sup>3</sup>. Ndërsa lojërat e tavolinës kanë mbetur tërësisht jashtë vëmendjes së studiuesve. Gjurmët arkeologjike të lidhura me to janë të panjohura, pak të ruajtura dhe rrallë tërheqin vëmendjen. Përveç ndonjë përmendjeje të rastësishme fushëlojash të gërvishtura nëpër objekte qeramike<sup>4</sup>, deri më sot nuk kemi asnjë studim apo artikull mbi lojërat që praktikoheshin në vendbanimet antike që shtrihen brenda territorit të Shqipërisë.

Në këtë artikull të shkurtër do të trajtojmë disa objekte të lidhura me lojërat e tavolinës, të luajtura në Durrësin antik. Nuk kemi përfshirë në këtë artikull dy tipe

---

<sup>1</sup> TOÇI 1971, 37-42; MIRAJ 1986, 151-169.

<sup>2</sup> ANAMALI 1958, 95-108; ANAMALI 1972, 75-80; CEKA 1987, 247.

<sup>3</sup> DRINI 1993, 133-142.

<sup>4</sup> SPAHIU, KOMATA 1974, 295; KOMATA 1991, 47; HOTI 1987, 251-252.

gjetjesh: rrotulla qeramike dhe astragalë. Të parat janë gjetje të rëndomta nëpër të gjitha gjermimet e realizuara dhe janë të shumta në numër, dhe jo vetëm në Durrës<sup>5</sup>. Por ato kanë pasur disa përdorime, jo vetëm si gurë loje. Ndërsa astragalët janë gjetur në disa gjermime shpëtimi në Durrës, në kontekste që më së shumti mund të lidheshin me mbeturina ushqimore sesa me lojërat. Prandaj edhe i kemi lënë jashtë këtij artikulli.

Nga gjermimet arkeologjike ose nga gjetjet e rastësishme në qytet kemi përzgjedhur disa objekte për të cilat nuk ka dyshime se i takojnë lojërave të tavolinës, të trajtuara në dy pjesë: gurë loje dhe tabela loje.

Në tekstet e autorëve antikë, si ato grekë edhe latinë, hasen përmendje të pakta të lojërave dhe të rregullave të tyre. Këta autorë bëjnë dallimin mes lojërave të kumarit dhe lojërave të tjera zbavitëse. Lojërat e kumarit, të quajtura *alea*, dënoheshin moralisht përgjatë antikitetit<sup>6</sup>, siç edhe haset në burimet antike (Herodotus, I, LXIII; Plutarchus, *Antonius*; Suetonius, *Caligula* 71; Iuvenalis, I 88-92; Martialis, XV 15). Kundër këtyre lojërave janë marrë edhe masa parandaluese nga vetë senati romak<sup>7</sup>, por që duket se nuk zbatoheshin me rreptësi, përderisa luanin edhe vetë perandorët (Suetonius, *Augustus* 71). Ndërsa lojërat zbavitëse autorët antikë i trajtojnë me tjetër konsideratë. Ndër përmendjet më të hershme të lojërave të tavolinës kemi atë të Homerit, kur përshkruan Penelopën që luante me “gurë” (*Odysseia* I, 107).

<sup>5</sup> Një përmendje të parë për «tesera loje» nga Durrësi e kemi tek HOTI 1988, 272. Në gjermimet shqiptaro-gjermane të teatrit të Apollonisë janë gjetur shumë objekte të tilla, në proces botimi. Jashtë territorit shqiptar po përmendim vetëm gjetjet nga gjermimet e Aeropagut të Athinës, ku janë identifikuar si *pesoi*, gurë loje, shiko KURKE 1999, 263, fig. 1.

<sup>6</sup> MAY 1995, 55. Këto lojëra luheshin kryesisht duke përdorur zare. Sipas Platonit (*Phaidros* 274D), i cili përcjell traditën egjiptiane, ishte perëndia Thot që shpiku lojën me zare. Ndërsa sipas Pausanias (X 31), shpikësi i lojës me zare ishte një grek, Palamedi. Për një listë përmendjesh të Palamedit dhe shpikjeve të tij, përfshirë lojërat, shiko KURKE 1999, 250-251. Sipas Herodotit (I 94, 1-7), ishin banorët e Lydisë që krijuan lojërat, përveç *pesoi*, në kohën e mbretit Atys. Ky mendim kundërshtohet nga Athenaeus (*Deipnosophistae* I 19a), i cili përmend origjinën e tyre «heroike», shumë kohë para se të jetonte mbreti Atys i Lydisë.

<sup>7</sup> HARTMAN 1894, 1358-1359.



Fig. 1. Gurë loje të zbuluara si inventar varri. Fotografia autori.

### Gurë loje.

1. Nr. Inv. 5240/4830 (Fig. 1, fotografia autori)<sup>8</sup>. Pabotuar.

Bëhet fjalë për 15 gurë loje, 10 të bardhë dhe 5 të zinj. Vërehen dallime mes tyre në përbërje dhe përmasa. Kanë një diametër nga 1.4 deri në 1.8 cm dhe lartësi 0.4 deri në 0.8 cm. Janë punuar prej materialesh të ndryshme. Për «gurët» e bardhë është përdorur pastë qelqi, gurë natyror dhe kockë. Për «gurët» e zinj vetëm pastë qelqi. «Gurët» e punuar prej paste qelqi janë të njëtrajtshëm në përmasa dhe formë: të sheshtë nga poshtë, të harkuar nga sipër. I ngjashëm në përmasa dhe trajtim është edhe «guri» i punuar prej kocke. Ndërsa ato që janë prej guri natyral janë të larmishëm në forma dhe përmasa. Këto gurë janë përdorur në gjendjen natyrale, pa u përpunuar.

Në botimet shqiptare nuk kam hasur të botuara objekte të ngjashme.

<sup>8</sup> Fondi Arkeologjik Durrës, Regjistri nr. 2, ku mungon prejardhja. Por vetë regjistri i takon «Nekropolit Helenistik», çka nënkupton gjetjen në nekropolin kodrinor.

Jashtë Shqipërisë të tillë gurë loje, apo të ngjashëm, janë përdorur përgjatë periudhave të ndryshme kohore. Në Maqedoninë antike janë zbuluar dhe botuar gjetje nga: Derveni (fundi shek. IV para Kr.), Methone (çereku i tretë i shek. IV para Kr.), Sevaste (shek. IV para Kr.) dhe Makriyalos<sup>9</sup>. Në Pydna janë gjetur gurë loje të datuara në vitet 350-300 para Kr., me ngjyra blu, jeshile dhe pa ngjyrë<sup>10</sup>. Në Golyama Kosmatka ato janë me dy ngjyra, blu të errët dhe të bardhë<sup>11</sup>.

Të datuara në periudhën romake hasen një sasi edhe më e madhe, si: Nimes, identikë me objektet tona, me tre ngjyra: të zeza, të bardha dhe portokalli; në Rheinischen Landesmuseum; në Muzeun Calvet, Avignon; në fondet e British Museum<sup>12</sup>. Një numër i lartë objektësh të ngjashme vijnë nga një nekropol i Brindisit<sup>13</sup>, ndërsa pranë Perugias janë gjetur 816 gurë loje prej qelqi ngjyrë blu, verdhë dhe të bardhë<sup>14</sup>.

Lojërat me gurë të tillë kanë qenë të njohura në zona të ndryshme të Mesdheut, së paku që nga shek. IV para Kr. dhe kanë vazhduar edhe përgjatë periudhës perandorake romake. Për rrjedhojë, nuk mund të ndihmojnë në datimin e gjetjeve tona, të cilat janë zbuluar në varrezën kodrinore të qytetit. Kjo varrezë ka një datim të përgjithshëm në shek. VI – I para Kr.<sup>15</sup> Gurët e lojës nga Durrësi nuk mund të jenë më të hershëm sesa shek. IV para Kr., dëshmuar nga gjetjet e deritanishme jashtë territorit shqiptar dhe nuk mund të zbresin përtej shek. I para Kr.

## 2. Gjetje rasti në pjesën verilindore të Durrësit<sup>16</sup> (Fig. 2a-b, fotografitë T.Sherif). Pabotuar.

Kjo zonë korespondon me varrezën romake të qytetit<sup>17</sup>, por nuk dimë nëse

<sup>9</sup> ΙΓΝΑΤΙΑΔΟΥ 1999, fig. 1-3, 6.

<sup>10</sup> ΙΓΝΑΤΙΑΔΟΥ 2002, 22-23, fig. 12.

<sup>11</sup> ΝΑΝΚΟΒ 2013, 278, fig. 9, varri është identifikuar se i takonte mbretit trak Seuthes III.

<sup>12</sup> *JOUER DANS L'ANTIQUITÉ*, 33 ; 33, fig. 3 ; 188, fig. 181 ; 189, fig. 182.

<sup>13</sup> COCCHIARO 1988, varri 42, mesi shek. I pas Kr. – f. 152, nr. 234, tre gurë loje prej paste qelqi të zi; varri 15, gjysma parë e shek. I pas Kr. – f. 174, nr. 316, treqindenjëzetekatër gurë loje, prej guri dhe mermeri.

<sup>14</sup> *DA ROMA ...* 2000, 35.

<sup>15</sup> HIDRI 1986, 99-113.

<sup>16</sup> Pjesë koleksioni privat.

<sup>17</sup> TARTARI 2004.

objekti në fjalë ka qenë pjesë inventari varri apo jo.

Një fragment fildishi është punuar në formë të rrumbullakët, me diametër 0.3 cm. Në pjesën qendrore të të dy faqeve ruhet nga një pikë e thelluar, ku besojmë se është vendosur aksi kapjes për tornim të copës së fildishit.

Faqja ballore është e gdhendur në relief të cekët. Pjesa anësore zbukurohet me linja rrethore të thelluara, pasuar nga një brez me trekëndësha të vegjël, të thelluar. Pjesa qendrore ka një motiv dekorues me tre shpendë të lidhur nga këmbët dhe të varur kokëposhtë. Dy prej tyre varen majtas dhe djathtas, me kokat që tentojnë të ngrihen lart, i treti, në mes, shikon nga lart poshtë.

Faqja e pasme është e sheshtë dhe pa zbukurime. Janë incizuar vetëm dy numra, në latinisht «XIII» dhe në greqisht «Γ». Në të dy rastet kemi shifrën 13.

Shembuj identikë janë gjetur si oferta varrore në varrezen romake të Brindisit, datuar ndoshta në gjysmën e parë të shek. I pas Kr.<sup>18</sup>

Përgjatë gërmimeve në Odeon të Korintit është gjetur një objekt pothuaj identik në profil<sup>19</sup>. Ka diameter prej 0.25 cm, punuar në fildish. Pjesa ballore ka dy profilime në buzë. Në qendër dallohet vrima e aksit të tornimit dhe një profilim anash saj. Në pjesën e pasme mbi vrimën qendrore të kapjes është numri «III» dhe poshtë saj «Δ». Autori mendon se objekti ka shërbyer si biletë teatri, dhe numrat i referohen njëres nga katër seksionet (kerkides) e kaveas. Autori shkruan se ky objekt ngjan shumë me një tjetër gjetje nga teatri Herculaneum. Një tjetër objekt i përmendur prej tij, të cilën nuk mundëm të gjejmë botimin, është nga Odeoni i Pericles, me incizim të emrit Αισχυλο dhe numrit 13, në greqisht dhe latinisht.



Fig. 2a. Gurë loje. Pjesa ballore.  
Fotografoi T. Sherif.



Fig. 2b. Gurë loje. Pjesa pasme.  
Fotografoi T. Sherif.

<sup>18</sup> COCCHIARO 1988, 161, 171, nr. 302, 305, 171-172, nr. 306, 172, nr. 308.

<sup>19</sup> CORINTH X, 141, f. 139.

Por në *Corinth XII* ky përcaktim rimerret në shqyrtim, duke u prezantuar si gurë loje dhe për më tepër me një sasi më të madhe gjetjesh<sup>20</sup>.

Objekte të ngjashme, por jo me të njëjtin dekor, kanë qenë të famshme në Mesdhe. Mendohet se këto tesserae janë punuar kryesisht në Aleksandri të Egjiptit<sup>21</sup>. Ndoshta një origjinë të ngjashme mund të ketë edhe objekti ynë.

### **Fusha loje**

3. Nr. Themeltar 3819/2563<sup>22</sup> (**Fig. 3**, fotografia autori). Pabotuar. Ekspozuar në Muzeun Arkeologjik Durrës.

Fragment tjegulle me përmasa 14.5x9 cm. Në njërën faqe është incizuar me linja të cekta një fushë loje, e njohur gjerësisht në popull si loja e «nëntëshit» apo «yçit».

4. Nr. Themeltar 6673<sup>23</sup> (**Fig. 4a-b**, fotografia autori). Pabotuar.

Fragment tjegulle, me përmasa 28x22 cm. Në të dy faqet është gdhendur loja e «nëntëshit» apo «yçit».

5. Nr. Themeltar 4079/114<sup>24</sup> (**Fig. 5**, fotografia autori). Pabotuar.

Fragment elementi arkitektonik, gdhendur në gur gëlqeror. Formë e çrregullt, me tendencë drejtëkëndore. Përmasat 42x15.5x12 cm. Lëmuar në pjesën e sipërme dhe të poshtme. Në pjesën e sipërme ka të gërvishtur me linja të cekta fushën e lojës së «nëntëshit» apo «yçit».

Në fshatin Kryevidh është zbuluar një fragment tulle (**Fig. 6**, sipas Hoti 1987), me gjatësi të ruajtur 29.5 cm dhe trashësi 4.8 cm. Në të dy faqet ruan të gërvishtura nga një fushë loje. Njëra lojë është ajo e «nëntëshit», me përmasa maksimale 15x22 cm. Linjat e gërvishtura nuk janë të drejta dhe të qarta, por janë realizuar disa të tilla për ti dhënë formë fushës së lojës. Fusha në faqen tjetër ka formë drejtëkëndore, me nga 4 kutiza për çdo krah. Disa linja diagonale përshkojnë kutizat, duke krijuar disa rombe. Vendi i gjetjes mendohet se i takon një ngrehine të shek. XI-XIII<sup>25</sup>.

<sup>20</sup> *CORINTH XII*, 217, pl. 100.

<sup>21</sup> Alföldi-Rosenbaum 1976, 205-239; Alföldi-Rosenbaum 1980, 29-39; Museo Nazionale Romano VI.1, 88-93.

<sup>22</sup> Fondi Arkeologjik Durrës, Regjistri nr. 1, Nekropoli helenistik. Gjetur në nekropolin e Kodrës së Dautës, 12.9.1965.

<sup>23</sup> Fondi Arkeologjik Durrës, gjetur në Amfiteatrin e qytetit, viti 1969.

<sup>24</sup> Fondi Arkeologjik Durrës, Regjistri 9. Mungon vendgjetja në regjistër, ku është datuar si gjetje e periudhës helenistike.

<sup>25</sup> HOTI 1987, 251-252.



*Fig. 3 Fragment tjegulle me lojën e nëntëshit.  
Fotografoi autori*

Në Shurdhah është gjetur një fragment amfore, mbi të cilën është gërvishur një tjetër fushë loje «nëntëshi», datuar nga autorët në shek. X-XI.<sup>26</sup> Autorët përmendim edhe dy gjetje të tjera të ngjashme, nga ish Jugosllavia dhe Rumania.

Në Kaninë është gjetur një tjegull ku është gërvishur një lojë e ngjashme, por nuk është dhënë ndonjë datim<sup>27</sup>.

E njëjta fushë loje, e gdhendur në një pllakë guri, është gjetur në një tumë në Sboryanovo (Bullgari)<sup>28</sup>. Në Singidunum janë gjetur dy fragmente tjegullash romake, me gërvishjen e të njëjtës lojë<sup>29</sup>. Në agoranë romake



*Fig. 4a Pjesa ballore e një fragmenti tjegulle me lojën e nëntëshit.  
Fotografoi autori.*



*Fig. 4b. Pjesa e pasme e një fragmenti tjegulle me lojën e nëntëshit.  
Fotografoi autori.*



*Fig. 5. Fragment elementi arkitektonik me lojën e nëntëshit. Fotografoi autori.*

<sup>26</sup> SPAHIU, KOMATA 1974, 295.

<sup>27</sup> KOMATA 1991, 47.

<sup>28</sup> NANKOV 2013, 287, fig. 12 dhe citimet përkatëse.

<sup>29</sup> JANKOVIĆ 2008, 11, nr. 15, fig. 13, nr. 16, fig. 14.

të Selanikut është gjetur në një pllakë argjile<sup>30</sup>. Në varrezën romake të Brindisit është gjetur në një varr të gjysmës së parë të shek. I pas Kr. një pllakë gëlqerore e fragmentuar, me gërvishje në të dyja faqet: njëra me dy fusha të lojës trishe dhe një fushë të lojës së nëntëshit, faqja tjetër me dy fusha të lojës trishe<sup>31</sup>.

Në pllakat e atriumit të një kishe në qytetin e Amorium është gdhendur kjo lojë<sup>32</sup>. I njëjti autor përmend edhe një tjetër shembull, nga një kishë e Efesos. Po nga Amorium përmenden të tilla lojëra të gërvishtura edhe në tulla.

Të tjera fusha loje janë identifikuar edhe përgjatë periudhave më të vona kohore. Në Beoti është gjetur një fragment ene qeramike ku ishte gërvishtur e njëjta fushë loje, datuar në mes të shek. XIII-XVII<sup>33</sup>. Autorja na jep edhe një listë të gjetjeve të ngjashme në Evropën veriore si dhe në Greqi.

Në ishullin e Rodit është gjetur një tjetër fushë loje, e gdhendur në një tjegull antike. Jane dhënë dy mundësi datimi për këtë gjetje, që të dyja mesjetare, të lidhura me urdhërin fetar të Shën Gjonit (St John, the Hospitalliers) ose me rrethimin e dytë osman të ishullit në 1522<sup>34</sup>.

Kuptohet qartë se kemi të bëjmë me një lojë e cila ka qenë në përdorim për një kohë të gjatë në Mesdhe. Edhe në Shqipëri këto gjetje fillojë nga antikiteti dhe përzgjatën deri në mesjetë. Fushat e Durrësit në aspektin kronologjik lidhen me kontekstin e gjetjeve:

Objekti i parë i gjetur në varrezën e shek. VI-I para Kr.<sup>35</sup>

Objekti i dytë në amfiteatrin e qytetit, por me kontekst të panjohur.

Objekti i tretë nuk ka të shënuar vendin e gjetjes.

## 6. Pllakë dyshemeje (Fig. 7, sipas Hoti etj. 2008).

Në pllakat e mermerta të Macellum-Forum bizantin të qytetit, në krahun perëndimor të tij, gjendet e gërvishtur një fushë loje rrethore. Ka diametër 55 cm dhe ndahet nga katër linja rrezore, duke krijuar tetë hapësira. Në pjesën fundore të linjave diagonale, ku ato prekin rrethin, janë incizuar tetë harqe. Mbi harqe është gdhendur nga një kryq. Ndërsa në hapësirat e krijuara poshtë harqeve janë gdhendur

<sup>30</sup> IYVAΤΙΑΟΥ1999, fig. 9.

<sup>31</sup> COCCHIARO 1988, 174, nr. 317.

<sup>32</sup> WITTE 2010, 390, fig. 4, 5.

<sup>33</sup> VROOM 1999, 93-110.

<sup>34</sup> SARANTIDIS 2014, 359-367.

<sup>35</sup> Për varrezën shiko HIDRI 1986, 99-113.






Fig. 6 Fragment tulle nga Kryevidhi, me fusha lojërash të gërvishtura. Sipas Hoti 1987.

germa në alfabetin grek, duke dhënë fjalët: TOO/NO/MA/+K/ωN/CT/AN/TI/N, përkthyer «Emri i Konstantinit»<sup>36</sup>. Nëse eliminojmë detajet dhe fjalët e shkruara, do të kishim një skicë të thjeshtuar, si në fig. 8.

Kjo fushë loje në bibliografinë ndërkombëtare identifikohet me lojën që në Shqipëri quhet loja «trische». Me këtë emërtim janë lidhur një mori fusha lojërash.

Gjetje të ngjashme për nga forma janë botuar në një nekropol romak në Lyon, gërvishtur në një pllakë guri; në bazilikën Julia në Romë dhe në Ostia të gërvishtura në mermer<sup>37</sup>. Fusha e gjetur në Lyon është e ngjashme me fushat e lojës të përdorura deri vonë në Shqipëri, katër linja që dalin në formë rrezore, brenda një kuadrati. Ndërsa fusha e Ostias ka katër linja brenda një rrethi. Fusha e gjetur në Romë është e ngjashme me atë të Ostias, por në pjesën e bashkimit të fundoreve të katër linjave me rrethin, është gërvishtur nga një gjysmë-rreth tjetër.




Fig. 6 Fushë loje e gërvishtur në pllakat e Forum-Macellumit bizantin të Durrësit. Sipas Hoti etj. 2008.




Fig. 7. Skicë e thjeshtuar e fushëlojës së Forum-Macellumit bizantin të Durrësit. Skicoi autori.

<sup>36</sup> HOTI etj. 2008, 378, përkthyer me pikëpyetje në anglisht «The Name of Constantine».

<sup>37</sup> BEDON 1989, 60, fig. 1-3.

Në forumin romak të qytetit afrikan të Timgad është zbuluar mbi pllakat e mermerta të dyshemesë një rreth (me diametër 60 cm), me katër linja diagonale që e ndajnë në tetë pjesë. Pjesa qendrore ka një rreth më të vogël, ndërsa në vendtakimet e linjave diagonale me rrethin mbivendoset një hark<sup>38</sup>.

Ne Ephesos ruhet e gdhendur një fushë loje rrethore, me 4 linja diagonale<sup>39</sup>.

Në pllakat e mermerta të agorasë të qytetit Iasos janë identifikuar gdhendje të ndryshme, ndër të cilat një skemë loje identike me atë të gjetur në Durrës. Por datimi duket i vështirë, duke parë fazat e ndryshme ndërtimore, duke u datuar në mes të shek. III-V pas Kr.<sup>40</sup>

Pothuaj identik me fushëlojën e Durrësit është ajo e gdhendur në pllakat e mermerta të hollit të madh verior të tregut të Philippi, e cila kish qenë përdorur më parë si portik i një macellumi. Këtu gjejmë të njëjtën strukturë loje, me harqet që lidhin fundoret e diagonaleve, me incizimin e dy fjalëve në alfabetin grek si dhe në përdorimin e kryqit si simbol fetar. Edhe germat e përdorura janë shumë të ngjashme, veçanërisht germat «ω» dhe «Α». Autori parashtron një seri çështjesh të lidhura me datimet e mundshme përgjatë antikitetit të vonë, nga shek. IV në shek. VI<sup>41</sup>.

Shumëllojshmëria e skemave për këtë lojë është e tillë sa ka qenë e nevojshme të krijohet edhe një tipologji më vete<sup>42</sup>. Fushëloja e Durrësit i takon tipit C6 “Circle with 8 spokes and 8 arcs”.

Datimi i fushëlojës së Durrësit lidhet me ndërtimin e monumentit ku është gjetur, për të cilin janë dhënë datimet: fundi shek. V – fillimi shek. VI<sup>43</sup> dhe vitet 480-510<sup>44</sup>.

## 7. Pllakë dyshemeje.

Në pllakat e mermerta të Macellum-Forum Bizantin të qytetit, pranë fushës së mësipërme është gdhendur një rreth, me diametër 45 cm. Këtë radhë kemi të bëjmë me një fushë loje të papërfunduar, pasi mungojnë linjat rrezore.

<sup>38</sup> BOESWILLWALD etj. 1905, 27.

<sup>39</sup> VROOM 1999, pl. VI.

<sup>40</sup> SERVADEI 2016, 16, 20, fig. 3.

<sup>41</sup> COUPRY 1946, 102-105, fig. 2.

<sup>42</sup> BELL, ROUECHÉ 2007, 106-109.

<sup>43</sup> HOTI ETJ. 2008, 394-395.

<sup>44</sup> SHKODRA 2006, 286.

## 8. Pllakë dyshemeje.

Në pllakat e mermerta të Macellum-Forum Bizantin të qytetit, pranë dy fushave të mësipërme është gdhendur një rreth, me diametër 50 cm. Me shumë vështirësi mund të dallohen gjurmët e katër linjave që ndanin rrethin në tetë pjesë. Ndoshta, pasi kjo fushë është bërë e papërdorshme, mund të jetë gdhendur fusha e mësipërme, nr. 6.

## Përfundime.

Në mbyllje le të përqipemi të bëjmë një shikim të shpejtë dhe të përmbledhur të lojërave që luheshin me gurët dhe tabelat që janë gjetur në Durrës.

Përdorimin e gurëve dyngjyrësh, të bardhë e të zinj, krijuar me qelq ose jo, e hasim të përmendur nga disa autorë antikë. Një pasazh i Pollux (*Onomasticon* IX 98), përmend ndarjen e gurëve të lojës në dy fusha kundërshtare, sipas ngjyrave që ato kanë. Përshkrim më të saktë e hasim në një shkrim të Calpurnius Siculus (ose Pseudo-Calpurnius, *Laus Pisonis*, 195-205), i cili përmend gurë loje prej qelqi, të bardhë apo të zinj. Në një tjetër pasazh, këtë radhë të Ovidit (*Tristia*, II 472), gjejmë përsëri përmendjen e gurëve të lojës me ngjyra të ndryshme. Fushën e lojës dhe gurët me të cilët luhej i hasim në një pasazh të Martial (*Epigr.* II 48, 4; XVIII 16), por në këtë rast, nuk bëhet dallimi mes ngjyrave të ndryshme të tyre. Përmendjen më të vonë në kohë, e kemi në vitin 463 pas Kr., tek Sidonius Apollinaris (*Lettres à Trygetius*, *Ep.*, VIII 12, 5), përsëri me gurë dyngjyrësh.

Por se për cilën lojë janë përdorur këto gure ka diskutime të ndryshme.

Sipas R.May, duhet të bëhet fjalë për një lojë me karakter luftarak, duke parë edhe përdorimin e termit *plinthion*, që ishte term ushtarak, përdorur për njësi trupash në fushëbetej<sup>45</sup>. Por, përveç faktit që përdoren shumë gurë loje dhe nevojitej avancimi në fushë për të eliminuar kundërshtarin, nuk dihet më shumë për rregullat e saj. Ndoshta një version romak i kësaj loje ishte *pettie*<sup>46</sup>, siç mund të kuptohet nga dy pasazhe tek Platoni (*Rep.* VI 487B) dhe tek Polibi (*Hist.* I 84).

Sipas B. de Fouquieres, kjo lojë identifikohet me *pente grammai*, loja e pesë vizave. Por, duke u bazuar tek përshkrimi i Pollux (*Onomasticon* IX 97), R.May e hedh poshtë një mundësi të tillë, pasi, sipas tij, rregullat e lojës ishin të ndryshme<sup>47</sup>.

<sup>45</sup> MAY 1995, 56.

<sup>46</sup> MAY 1995, 57, fjalën greqisht *πεπτευτης* tek Polibi dhe *πεπτευειν* tek Platoni, e përkthen *pettie*, lloj loje. Ndërsa përkthimet nga greqishtja vjetër në frëngjisht, që kemi përdorur në për tekstet e dy autorëve antikë, e përkthejnë thjesht «joueur habile», pa dhënë emërtimin e lojës tek Polibi, dhe «trictrac» tek Platoni.

<sup>47</sup> MAY 1995, 57.

Ndër lojërat romake që përdorte gurë shumëngjyrësh ishte *latroncule* ose *ludus latrunculorum*. Përmendjet nga autorët latinë janë të ndryshme, por më gjerë e hasim tek Calpurnius Siculus (*Laus Pisonis 195-205*). Sipas këtij përshkrimi, fushëloja ndahej në 8x8 kuadrate. Ndoshta, një fushë e këtij modeli, mundet të jetë paraqitur edhe në disa relieve dhe, për më tepër, nuk ka asnjë zar të paraqitur. Kjo që ka bërë që të lidhet me termin *latroncule*, ku parimi i lojës është i ngjashëm me *polis* të përmendur nga autorët grekë, ku synohej eliminimi i gurëve të kundërshtarit<sup>48</sup>. Ndërsa si emërtim mendohet se vjen nga fjala *latro* – ushtar, mercernar<sup>49</sup>. Gurët e lojës në këtë rast quheshin *latrones*, të cilët mund të ishin prej guri apo qelqi, me ngjyra të ndryshme; disa prej tyre mund të kishin edhe zbulurime në reliev, si në rastin e 15 gurëve prej kocke dhe fildishi të Muzeut të Teatrit të Scala në Milano (me gdhendje numrash në latinisht e greqisht) apo të 6 copëve të Antiquarium Comunale të Romës<sup>50</sup>.

Një tjetër lojë e preferuar nga romakët ishte *ludus duodecimscriptorum*, për të cilën nuk ka mendime të njëjta mbi fushën ku luhej<sup>51</sup>. Bëhet fjalë për një fushë ku gërvishten tre rreshta, me nga 12 shenja ose germa, të ndara në dy pjesë nga një ndarje vertikale. Shpesh herë, në vend të shenjave vendoseshin germa pa kuptim ose që krijojnë fjali të plota<sup>52</sup>.

Bazuar në një epigramë të famshme të Agathias, ku përshkruan lojën e bërë nga perandori Zeno (IX 482), janë bërë disa tentativa për të kuptuar më qartë organizimin e lojës dhe fushës së përdorur, nëse ishte fusha e përshkruar më sipër apo një version tjetër, me dy linja dymbëdhjetëshe, me nga gjashtë ndarje secila, e ngjashme me tavllën e sotme<sup>53</sup>. Kjo lojë u përhap aq shumë dhe me vendosje

<sup>48</sup> MAY 1995, 58.

<sup>49</sup> DA ROMA ... 2000, 35.

<sup>50</sup> DA ROMA ... 2000, 35, figura pa numër në faqe 37.

<sup>51</sup> MAY 1995, 59, ndërsa autorët e tjerë mendojnë se loja e 12 linjave është e ndryshme nga ajo që R.May përshkruan; sipas DA ROMA ... 2000, 38, kishte rregulla të ngjashme me «tric-trac» apo «backgammon», me «damën» tonë.

<sup>52</sup> MAY 1995, 59-60; BEDON 1989, 62-63, fig. 5-7; MAY 1995, 59, 60; ESPÉRANDIEU 1938, nr. 7725, 48-49.

<sup>53</sup> DE FOUQUIÈRES 1869, 357-383, i kushton një kapitull të tërë analizës së kësaj loje, ku përshkrimin e Agathias e vendos tek loja e 12 rreshtave/germave; Lamer e konsideron si lojë të ndryshme, por të paidentifikuar, shiko LAMER 1927, 1900-2029; ndërsa R.G.Agustin, i cili është i të njëjtit mendim me Lamer, se kemi të bëjë me një lojë të ndryshme, duke mos pranuar organizimin e H.Jackson, e identifikon emrin e saj me lojën ταβλην të përshkruar nga Agathias, shiko AUSTIN 1934, 202-205.

bastesh, saqë në Sinodin e Elvira në vitin 305 pas Kr. u ndalua loja me baste, ndërsa rreth vitit 730 u ndalua tërësisht praktikimi i saj<sup>54</sup>. Por çka është më e rëndësishme, është përdorimi i dy palë gurëve, të bardhë e të zinj, si ato që janë gjetur në Durrës.

Për gurët e përdorur për këtë lojë ka gjithashtu dëshmi që kanë pasur numra të gdhendur nga I në XV në njëren faqe, ndërsa faqja tjetër me zbukurime<sup>55</sup>. Ky përshkrim ngjason me objektin tonë nr. 2.

Emri antik i lojës së nëntëshit (marelle), mbetet i paqartë: ndoshta *triodion* për grekët, i panjohur për romakët<sup>56</sup>. Forma e saj mund të ishte katrore ose e rrumbullakët, e thjeshtë ose me zbukurime, me harqe apo rrathë. Sipas Breyer 2010 loja trishes që praktikohet sot nuk shfaqet para shek. 17<sup>57</sup>. Por përshkrimi i Ovidit në dy tekste të ndryshme: «... *sur l'art de disposer sur un petit damier trois pieces par jouer, la victoire étant à celui qui les a places sur la meme lignes*»<sup>58</sup> (Ovide, *Tristia*, II 481; Ovide, *Ars Amatoria*, III 365) të shtyn të mendosh se rregullat që luhen në Shqipëri kanë qenë të ngjashme me ato të antikitetit. Ndërsa fusha e lojës rrethore e ndarë me linja diagonale dhe me harqe, luhej deri në fillim të viteve 90 të shekullit të kaluar në Shqipëri, por me rregulla të ndryshme nga loja “trische”. Njëri lojtar kishte tre gurë, kundërshtari një gur. Praktikisht, lojtari i parë synonte të bllokonte lojtarin e dytë në një pozicion pa mundësi lëvizjeje.

Siç kuptohet nga kjo përmbledhje, diskutimet mbi lojërat, rregullat, gurët e përdorur dhe fushëlojat vazhdojnë ende në disa drejtime. Shpesh herë edhe në kundërshti me njëra-tjetrën. Për rrjedhojë, mbetet e vështirë për ne të saktësojmë me siguri nëse 15 gurët dyngjyrësh janë përdorur për *pente grammi*, *polis*, *latroncule* apo për të gjitha së bashku. Guri me gdhendjen në relief ndoshta mund të jetë përdorur për lojën e *ludus duodecimscriptorum*. Fushëlojërat trishe, nëntësh, damë ndihmojnë për të kuptuar më shumë për lojërat që luheshin. Në këto raste është më e thjeshtë për të vendosur edhe emrat antikë për to. Dallimet kohore të gjetjes së tyre tregojnë për një vazhdimësi kronologjike të konsiderueshme. Kjo dëshmohet edhe nga vazhdimi i përdorimit të këtyre lojërave ende në ditët e sotme.

<sup>54</sup> DA ROMA ...2000, 40.

<sup>55</sup> DA ROMA ... 2000, 39

<sup>56</sup> BREYER 2010, 99.

<sup>57</sup> BREYER 2010, 99.

<sup>58</sup> Përkthyer në frëngjisht nga DE FOUQUIÈRES 1869, 389.

**BIBLIOGRAFIA**

ALFÖLDI-ROSENBAUM 1976

E.Alföldi-Rosenbaum, «Alexandriaca, Studies on Roman Game Counters III», *Chiron* 6, 1976, 205-239.

ALFÖLDI-ROSENBAUM 1980

E.Alföldi-Rosenbaum, «Ruler Portraits on Roman Game Counters from Aleksandria», në *Eikones. Studien zum griechischen und römischen Bildnis Hans Jucker zum sechzigsten Geburtstag gewidmet*, Berna 1980, 29-39.

AUSTIN 1934

R.A.AUSTIN, «Zeno's Game of ταβλη (A.P. ix 482)», *The Journal of Hellenistic Studies*, vol. 54, part 2, 1934, 202-205

ART DU JEU

*Art du jeu. Jeu dans l'art. De babylone à l'occident medieval*. Musée de Cluny – Musée national de Moyen Age, 28 novembre 2012 – 4 mars 2013, Paris 2012.

ANAMALI 1958

S.ANAMALI, «Rezultatet e gjermimeve në stadiumin antik të Ploçës», *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore* 2, 1958, 95-108.

ANAMALI 1972

S.ANAMALI, «Amantia», *Iliria* 2, 1972, 61-133.

BEDON 1989

R.BEDON, «Les jeux de société chez les romains», *Archéologia* 46, mai 1989, 59-64.

BELL, ROUECHÉ 2007

R.C.BELL, C.M.ROUECHÉ, «Graeco-Roman pavement signs and game boards: a British Museum Working Typology», në I.Finkel (bot.), *Ancient Board Games in Perspective: papers from the 1990 British Museum colloquium with additional contributions*, London 2007, 106-109

BOESWILLWALD ETJ. 1905

E.BOESWILLWALD, R.CAGNAT, ALB.BALLU, Timgad, *Une cité africaine sous l'empire romain*, Paris 1905.

BREYER 2010

C.BREYER, *Jeux et jouets à travers les âges. Histoire et règles de jeux égyptiens, antiques et médiévaux*, Bruxelles 2010.

CEKA 1987

N.CEKA, «Gjermimet arkeologjike të vitit 1987, Bylis-Agora», *Iliria* 2, 1987, 246-248.

## COCCHIARO 1988

A.COCCHIARO, «La necropoli», në A.COCCHIARO, G.ANDREASSI (bot.), *La necropoli di via Cappuccini a Brindisi*, Brindisi 1988, 63-230.

## CORINTH X

O.BRONEER, *Corinth. Results of Excavations conducted by The American School of Classical Studies at Athens. Vol. X. The Odeum*. Harvard University Press, Cambridge Massachusetts 1932.

## CORINTH XII

G.R.DAVIDSON, *Corinth. Results of Excavations conducted by The American School of Classical Studies at Athens. Vol. XII. The Minor Objects*. Harvard University Press, Cambridge Massachusetts 1952.

## COUPRY 1946

J.COUPREY, «Un joueur de marelle au marché de Philippes», *Bulletin de Correspondance Hellénique* 70, 1946, 102-105.

## DA ROMA ... 2000

*Da Roma per gioco. Giochi e giocattoli nell'antica Roma*. Guida Breve (mostra). Museo di Antichità. Collezioni Archeologiche, Milano 2000.

## DE FOUQUIÈRES 1869

L.BECQ DE FOUQUIÈRES, *Les jeux des anciens. Leur description, leur origine, leurs rapports avec la religion*, Paris 1869.

## DRINI 1993

F.DRINI, «Dëshmi epigrafike dhe letrare për organizimin e lojërave në trevat ilire dhe për konkurrimin e përfaqësuesve të tyre në lojërat e mëdhatë Greqisë», *Iliria* 1-2, 1993, 133-142.

## ESPÉRANDIEU 1938

E.ESPÉRANDIEU, *Recueil general des bas-reliefs, statues et bustes de la Gaule romaine*, vol. 11, supplements, Paris 1938.

## HARTMAN 1894

D.HARTMAN, «Aléa», në G.WISSOWA (bot.), *Paulus, Real-Encyclopädie der Classischen Altertumswissenschaft*, Stuttgart 1894, 1357-1359.

## HIDRI 1986

H.HIDRI, «Nekropoli antik i Dyrrahut», *Iliria* 2, 1986, 99-113.

## HOTI 1987

A.HOTI, «Ndihmesë për hartën arkeologjike të rrethit të Durrësit», *Iliria* 1, 1987, 247-275.

## HOTI 1988

A.HOTI, «Gërmimet arkeologjike të vitit 1988, Durrës-Qytet», *Iliria* 2, 1988, 271-272.

## HOTI ETJ. 2008

A. HOTI, J. WILKES, E. METALLA, B. SHKODRA, «The early Byzantine circular Forum in Dyrrachium (Durres, Albania) in 2002 and 2004-2005: Recent recording and excavation», *The Annual of British School at Athens*, No. 103, 2008, 367-397.

ΙΓΝΑΤΙΑΔΟΥ 1999 Δ.Ιγνατιάδου, «ΕΛΛΗΝΙΣΤΙΚΟ ΕΠΙΤΡΑΠΕΖΙΟ ΠΑΙΧΝΙΔΙ ΜΕ ΓΥΑΛΙΝΟΥΣ ΠΕΣΣΟΥΣ», në *Anicent Macedonia. Sixth International Symposium*, Vol. 1, 1999, 507-522.

## IGNATIADOU 2002

D. IGNATIADOU, «Colorless glass in late classical and early Hellenistic Macedonia», *Journal of Glass Studies* 44, 2002, 11-24.

## JANKOVIĆ 2008

M.A.JANKOVIĆ, «Roman board games in Singidunum and its environs», *Годишњак града Београда*, Књ. LV, 2008, 1-14.

## JOUER DANS L'ANTIQUITÉ

R.MAY (bot.), *Jouer dans l'Antiquité, catalogue de l'exposition*, Musée d'archéologie méditerranéenne de Marseille, novembre 1991-février 1992.

## KOMATA 1991

D.KOMATA, *Qyteti iliro-arbëror i Kaninës*, Tiranë 1991

## KURKE 1999

L.KURKE, «Ancient Greek Board Games and How to Play Them», *Classical Philology*, vol.94, nr.3, 1999, 247-267.

## LAMER 1927

H.LAMER, «Lusoria tabula», në *Pauly Wissowa Realencyclopädia der classichen Altermtumswissenschaft* 13: 2.

## MAY 1995

R.MAY, «Les jeux de table ne Grèce et à Rome», *Bulletin de l'Association Guillaume Budé*, nr. 1, mars 1995, 51-61.

## MIRAJ 1986

L.MIRAJ, «Amfiteatri i Durrësit», *Iliria* 2, 1986, 151-169.

## Museo Nazionale Romano VI.1

«Le pedine Alessandrine», në *Museo Nazionale Romano. Avori ed ossi*, a cura di A.Giuliano, VI.1. Testo e redazione A.Caravale, Roma 1994, 88-93.

## NANKOV 2013

E.NANKOV, «Playful in live and after death: board games in early Hellenistic Thrace», në V.Sîrbu, R.Ştefanescu (ed.) *Necropolis, Cult places, Religion, Mythology. The Thracians and their Neighbors in the Bronze and Iron Ages*. Proceedings of the 12<sup>th</sup> International Congress of Thracology, Târgovişte 10-14 september 2013, vol. 2, 277-288, Brasov 2013.



## VROOM 1999

J.VROOM, «Playing games in the Valley of Muses. A medieval board game found in Beotia, Greece, Pharos», *Journal of the Netherlands Institute at Athens*, vol. VII, 1999, 93-110.

## WITTE 2010

J.WITTE, «Freizeitbeschäftigung in Amorium: Die Spiele», në F.Daim, J.Drauschke (bot.), *Byzanz-das Römerreich im Mittelalter*, 2.1, RGZM 2010, 387-394.

## SARANTIDIS 2014

K. SARANTIDIS, «ΠΗΛΙΝΟ ΕΠΙΤΡΑΠΕΖΙΟ ΠΑΙΧΝΙΔΙ ΑΠΟ ΤΗΝ ΠΟΛΗ ΤΗΣ ΡΟΔΟΥ (A clay board game table from the city of Rhodes)», *σοφία ἄδολος τιμητικὸς τομὸς γιὰ τὸν ἰωάννη χρ. παπαχριστοδουλου*, Ρόδος 2014, 359-367.

## SERVADEI 2016

C.SERVADEI, «Graffiti con schemi di gioco nell'agorà di Iasos: esempi dalla stoà orientale», *Bolletino dell'Associazione Iasos di Caria*, 22, 2016, 16-21.

## SPAHIU, KOMATA 1974

H.SPAHIU, D.KOMATA, «Shurdhahu-Sarda qytet i fortifikuar mesjetar shqiptar», *Iliria* III, 1974, 257-328.

## SHKODRA 2006

B. SHKODRA, «Ceramica tardoantica dal macellum-forum di Durres», *Quaderni Friulani di archeologia*, Anno XVI-N.1-Dicembre 2006, 257-289.

## TARTARI 2004

F.TARTARI *Nekropoli i Dyrrahut*, Durrës 2004.

## TOÇI 1971

V.TOÇI, «Amfiteatri i Dyrrahut», *Monumentet* 2, 1971, 37-42.

## SUMMARY

---

### *TESSERAE AND TABULAE LUSSORIE DISCOVERED IN DYRRACHIUM*

From archeological excavations or from random findings in the city we have selected some objects for which there is no doubt that they belong to board games, treated in two parts: game pieces and game boards.

#### **Game pieces.**

##### **1. Nr. Inv. 5240/4830 (Fig. 1). Unpublished.**

There are 15 game pieces, 10 white and 5 black, with differences between them in composition and size. They have a diameter of 1.4 to 1.8 cm and a height of 0.4 to 0.8 cm and are made of various materials: glass pastes, natural stones and bone.

Outside Albania such game pieces, or the like, have been used over different periods of time. In ancient Macedonia are discovered and published findings dating back to the 4<sup>th</sup> cent.BC. Dating during the Roman period there is an even greater amount of finds.

Such game pieces have been popular in various Mediterranean regions, at least since the 4<sup>th</sup> cent.BC and have continued throughout the Roman Empire period. Consequently, they can not help in dating our findings, which were discovered in the hilly cemetery of the city. This cemetery had a chronological use during 6<sup>th</sup>-1<sup>st</sup> cent. BC. The game pieces from Durres can not be earlier than the 4<sup>th</sup> cent.BC, evidenced by the findings so far outside the Albanian territory and can not go beyond the 1<sup>st</sup> cent.BC.

**2. Random finding in the northeastern part of Durrës (Fig. 2a-b). Unpublished.**

This area corresponds to the Roman necropolis, but we do not know whether the object in question was part of a tomb inventory or not.

An ivory fragment was carved in a circular shape, with a diameter of 0.3 cm. The front side is engraved in shallow relief, decorated in circular frames and in the center. The central part has a decorative motif with three birds tied up by the feet and hanging upside down.

The back side is flat and unobtrusive. Only two numbers were recorded, in Latin "XIII" and in Greek "II". In both cases we have the number 13.

Somewhat similar examples have been found in several roman settlements and cemeteries in the Mediterranean.

**Game boards**

**3. Nr. Inv. 3819/2563 (Fig. 3). Unpublished. Exhibited at the Durrës Archaeological Museum**

Tile fragment of 14,5x9 cm. On one face is incised with a shallow line the game board known as "nine men's morris".

**4. Nr. Inv. 6673 (Fig. 4a-b). Unpublished.**

Tile fragment of 28x22 cm. On both faces are incised the game boards known as "nine men's morris".

**5. Nr. Inv. 4079/114 (Fig. 5). Unpublished.**

Fragment of architectural element, carved in limestone. Preserved as irregular shape, with rectangular tendency. Dimensions 42x15,5x12 cm. Polished in the upper and lower part. In the upper part there are scratched lines of the "nine men's morris".

In Albania, such games boards are found incised in tiles and amphora fragments. Outside Albania, a number of similar findings have been published. The Durrës game boards in chronological terms are related to the context of the findings:

- The first game board was found in the necropolies of the 6<sup>th</sup>-1<sup>st</sup> cent. BC.
- The second one was found in the city's amphitheater, but with an unknown context.
- The third game board does not mark the location of the find.

### **6. Floor slab (Fig. 7, following Hoti etc. 2008).**

On the marble slabs of the town's late antique Macellum Forum, on its western side, a circular game board is incised. It has a diameter of 55 cm and is divided by four radial lines. At the bottom of the diagonal lines, where they touch the circle, eight arches are incised. Over each of the arches is carved a cross. While in the spaces created below the arches are carved the letter in the Greek alphabet, giving the words: TOO / NO / MA / + K / ωN / CT / AN / TI / N, translated "Name of Konstantin".

Similar findings have been published outside Albania. Almost identical to the Durrës game board is that carved on the marble slabs of the vast northern foothold of the Philippi market, dating between 4<sup>th</sup> to 6<sup>th</sup> cent.AD.

The dating of the Durrës game board is related to the construction of the monument where it was found, for which have been published two similar chronologies: the end of the 5<sup>th</sup> beginning of the 6<sup>th</sup> cent. and the years 480-510.

### **7. Floor slab.**

On the marble slabs of the town's late antique Macellum Forum, near the above game board, is incised a circle with a diameter of 45 cm. This time we are dealing with an unfinished game board, as the radius lines are missing.

### **8. Floor slab.**

On the marble slabs of the town's late antique Macellum Forum, near the two above game boards, is incised a circle with a diameter of 50 cm. With many difficulties can be distinguished the tracks of four radial lines. Perhaps, since this game board has become unusable, could have been incised the above game board no. 6.

### **Conclusions.**

Discussions on ancient games, rules, game pieces and game boards still continue. Often even in contradiction with each other. Consequently, it remains difficult for us to declare with certainty whether the 15 game pieces are used for *grammai*, *polis*, *latroncule* games or all together. The game piece with relief decorations could have been probably used for the *ludus duodecimscriptorum* game. The game boards helps to understand more about the playing games. In these cases it is easier to set the ancient names for them. The chronological differences between their finding contexts indicate a considerable chronological continuity in their use. This is evidenced even by the continued use of these games still today in Albania.